REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
KOLEGJI DOKTORAL

# PROCEDURA E KONKURRIMIT

Konkurrimi do të kalojë nëpër tri faza:

**• FAZA 1**
**VLERËSIMI I DOKUMENTACIONIT PËR APLIKIM**
Këtu vlerësohen kualifikimet dhe dokumentacioni i dorëzuar nga kandidatët. Pikët maksimale janë 50, të ndara si më poshtë:
- nota mesatare mbi 8 (10 pikë)
- projekti kërkimor i paraqitur (20 pikë)
- publikime të mëparshme (10 pikë)
- vlerësimi i përmbledhjes së temës së masterit (5 pikë)
- përvojë në mësimdhënie (5 pikë)

Brenda datës **8.05.2024** në mjediset e Fakultetit të Shkencave Humane, afishohet lista e studentëve fitues për këtë fazë.

**• FAZA 2**
**PROVIMI ME SHKRIM**
Pikët maksimale janë 25. Testi kalohet me minimumi 10 pikë. Testi konsiston në zhvillimin me shkrim të një tematike të caktuar nga departamenti i gjuhësisë. Temat publikohen bashkë me shpalljen e konkurrimit.
Provimi me shkrim do të zhvillohet në mjediset e Fakultetit të Shkencave Humane, më datë **10.05.2024**, ora 10.00-12.00, salla nr. 324, kati i tretë.

**• FAZA 3**
**PROVIMI ME GOJË**
Pikët maksimale janë 25. Provimi me gojë konsiston në një prezantim të detajuar të projektit të kërkimit, të prezantuar nga kandidati, si edhe certifikimin e njohurive në gjuhë të huaj. Provimi me gojë do të zhvillohet në mjediset e Fakultetit të Shkencave Humane, më datë **14.05.2024**, ora 10.00-14.00, salla nr. 324, kati i tretë.

*Pas përfundimit të tri fazave, Kolegji Doktoral shpall brenda datës* ***16.05.2024*** *listën me renditjen e plotë të aplikantëve sipas pikëzimit dhe brenda afate kohore të përcaktuara. Kandidatët që kanë marrë më shumë pikë, kualifikohen sipas kuotave të miratuara, 2 (dy) kandidatë. Aplikanti mund të njihet mbi vlerësimin e tij nëpërmjet*

*kërkesës drejtuar Kolegjit Doktoral. Aplikanti merr përgjigje me shkrim brenda 10 ditëve nga momenti i depozitimit të kërkesës.*